DREJTUAR:
KËSHILLIT MËSIMOR-SHKENCOR TË FAKULTETIT PEDAGOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në pajtim me nenin 172 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2018 dhe Gazet Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 178/2021 dhe 58/2024), me Vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës, me nr. 24-1647/1 të datës 09.11.2026, në bazë të Konkursit të shpallur më 03.10.2026 në gazetat ditore „Koha“ dhe „Sllloboden Peçat“ si dhe në web faqen e Universitetit të Tetovës të datës 03.10.2026 www.unite.edu.mk, për zgjedhjen e një asistenti në lëmin Edukim special dhe rehabilitim (5.03.00.10 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Programin studimor Edukim special dhe rehabilitim, u zgjodh unanimisht Komisioni recensues në këtë përbërje:

1. **Prof. dr. Arita Agai, profesor inordinar në Universitetin e Tetovës në Tetovë, (kryetar)**
2. **Prof. dr. Buniamin Memedi, profesor ordinar në Universitetin e Tetovës në Tetovë, (anëtar)**
3. **Prof. dr. Teuta Ramadani Rasimi, profesor inordiar në Universitetin e Tetovës në Tetovë, (anëtare)**

Duke falënderuar për besimin e dhënë, Komisioni recensues dorëzon këtë:

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE TË NJË ASISTENTI NË LËMIN EDUKIM SPECIAL DHE REHABILITM (5.03.00.10 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË PROGRAMIN STUDIMOR EDUKIM SPECIAL DHE REHABILITIM TË FAKULTETIT PEDAGOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

I. Në konkursin e shpallur në gazetat ditore „Koha“ dhe „Sllloboden Peçat“ të datës 03.10.2026 si dhe në ueb-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk, për zgjedhjen - rizgjedhjen e një asistenti në lëmin Edukim special dhe rehabilitim (5.03.00.10 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në Programin studimor Edukim special dhe rehabilitim, është paraqitur vetëm kandidatja Mr.sc.

Zana Kadrii Vladi. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe të dhënave të tjera të kandidatit, Komisioni recensues jep këto konstatime dhe vlerësime:

Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidatja Mr. Sc. Zana Kadrii Vladi, e lindur më datë 09.10.1995 në Tetovë, me vendbanim në Reçicë të vogël, Komuna e Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut. Ka kryer shkollën fillore në f. Strimnicë, Komuna e Zhelinës dhe shkollën e mesme mjekësore "Nikolla Shtejn" në Tetovë. Në vitin 2017 ka kryer studimet në ciklin e parë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin Pedagogjik, programi studimor: Edukim special dhe rehabilitim, me gjithsej 240 ECTS duke fituar thirrjen: Edukator special dhe rehabilitues i diplomuar.

Në vitin 2019 i regjistron studimet e magjistraturës në Fakultetin Filozofik, në programin studimor Edukim Special dhe Rehabilitim - drejtimi Dëmtimet në të parë, në Universitetin "Sh. Kiril dhe Metodij" në Shkup, ku më datë 09.12.2021 e mbron temën me titull: "Përgatitja e mësimdhënësve në shkollat e rregullta në arsimin gjithpërfshirës për fëmijët e verbër në, Komunën e Tetovës" nën mentorimin e Prof. dr. Daniela Dimitrova Radojiçiq.

Më 23.01.2023, është regjistruar në studimet e ciklit të tretë, në Universitetin "Sh. Kiril dhe Metodij" në Shkup, në fakultetin Filozofik, Programi studimor: Defektologji, që vërtetohet sipas Marrëveshjes për studime të ciklit të tretë, të lëshuar nga Dekani i Fakultetit Filozofik me nr. 10-20/3 i datës 23.01.2023. Ku aktualisht i ka përmbyll të gjitha provimet e semestrit të gjashtë dhe është fokusuar në kërkimin shkencor për mbrojtjen e disertacionit të doktoraturës dhe avancimin e mëtejshëm të kompetencave të saj profesionale në këtë fushë specifike.

Nga shtatori i vitit 2017, është e angazhuar si asistent part-time në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Pedagogjik, Programi studimor Edukim special dhe rehabilitim.

Në shkurt të vitit 2020 është punësuar edhe në Qendrën për Karrierë në Universitetin e Tetovës.

Në dhjetor të vitit 2023 është angazhuar si asistent full-time në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Pedagogjik, Programi studimor Edukim special dhe rehabilitim.

Me dokumentacionin e dorëzuar në konkurs, kandidatja ka dorëzuar edhe certifikatë për njohjen e gj.angleze.

1. Veprimtaria edukative-mësimore:

Nga viti akademik 2023/2024 deri në vitin 2026/2027 si asistent full-time ka mbajtur ligjërata në këto lëndë: Metodika e punës së nxënësve me dëmtime të lehta intelektuale, Intervenimi i hershëm, edukimi dhe rehabilitimi me anë të lojës te fëmijët me nevoja të veçanta, Hyrje në edukim special dhe rehabilitim, Orientim profesional, aftësim dhe punësim, Metodika e punës me nxënës me dëmtime në të parë. Gjithashtu edhe ushtrimet e lëndëve të lartëpërmendura dhe në lëndë tjera si: Terapia okupative, Ergoterapia, Metodika e punës me persona me aftësi të kufizuar intelektuale të mesme, rëndë dhe të kombinuar, Intervenimi i hershëm dhe edukimi i fëmijëve me dëmtime motorike.

Ka qenë e angazhuar në realizimin e aktiviteteve praktike për studentët e Edukimit special dhe rehabilitimit edhe të Logopedisë, bashkëpunëtore në organizimin e vizitave në kuadër të Fakultetit pedagogjik, Programi studimor- Edukim special dhe rehabilitim për të pasur qasje direkte studentët me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ka qenë anëtare e komisionit të temave të diplomës të 49 studentëve të Edukimit special dhe rehabilitimit.

Ka qenë anëtare e ekipit të projektit kërkimor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Fakultetin Filozofik të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, mbi analizën e modelit të mbështetjes arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat fillore, përmes Qendrave Burimore dhe Qendrave të Mbështetjes. Maqedonia e Veriut.

2.Veprimtaria kërkimore-shkencore

2.1 Punime shkencore të botuara dhe konferenca shkencore

1. Agai, A., Kadrii-Vladi, Z., & Shkodra, E. (2026). The impact of teachers' knowledge and readiness to develop individualized education plans on the motivation of students with special educational needs. Education, 8(15–16), 32–39. https://doi.org/10.62792/ut.education.v8.i15-16.p3220
2. Ramadani Rasimi, T., Agai, A., Kadrii, Z., & Izeti Zejneli, A. (2025, 12-13 Nëntor). Academic domains and developmental difficulties in lower primary education: A pilot study on the evaluation of the Handbook for assessing students' learning abilities in North Macedonia [Prezantim punimi].Konferenca e VI-të Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Pedagogjik, Universiteti i Tetovës, Tetovë,Maqedonia e Veriut
3. Kadrii Vladi Z., Agai, A. (2025), Arsimi gjithëpërfshirës, roli i asistentit arsimor në klasë; Kosova International Conference on Educational Research – KICER, Prishtinë, 26–27 qershor

4. Kadrii Vladi, Z., & Dimitrova Radojichikj, D. (2025). BLIND STUDENTS AND INCLUSIVE EDUCATION IN REGULAR SCHOOLS: TEACHERS' CONCERNS ACCORDING TO THEIR GENDER. KNOWLEDGE - International Journal , 69(2), 437–440. https://ojs.ikm.mk/index.php/kij/article/view/7256
5. Kadrii Vladi, Z., & Ramadani Rasimi, T. (2025). Socialization of children with special needs in pre-school institutions. EDUCATION Journal of educational research, 177-181. https://eprints.unite.edu.mk/2116/1/EDucation_2025-177-181.pdf
6. Зана Кадрии, Даниела Димитрова Радојичиќ, Арита Агаи, „ПОДГОТВЕНОСТ НА НАСТАВНИЦИТЕ ОД РЕДОВНИТЕ УЧИЛИШТА ЗА ИНКЛУЗИВНО ОБРАЗОВАНИЕ НА СЛЕПИТЕ УЧЕНИЦИ„, Меѓународна Научно-Стручна Конференција-Образование на лицата со Попреченост-Актуелни состојби и Перспективи, Зборник на трудови, ISBN:978-606-238-220-3 (Филозофски факултет), ISBN: 978-608-217-111-1(Универзитет во Тетово), ISBN:978-608-65438-8-4 (Сојуз на специјални едукатори и рехабилитатори на РСМ), 13-15 Октомври 2022, Скопје.
7. Arita Agai, Ermira Bajrami, Zana Kadri, Classroom funktioning with and without an educational assistant, Book of Abstracts, ISCFPE 22, 3rd International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy, 16-18 November 2022, University of Tetova, pg. 454, ISBN:978-608-217-113-5
8. Zana Kadrii Vladi, Arita Agai, „CHALLENGES DURING PROFESSIONAL EDUCATION AND EMPLOYMENT OF PERSONS WITH SPECIAL NEEDS", Book of Abstracts, ISCFPE 23, 4th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy, 15-17 November 2023, University of Tetova, pg. 429, ISBN: 978-608-217-110-4

Të gjitha konferencat janë të dokumentuara me çertifikata për pjesëmarrje, ndërsa punimet shkencore janë të dorëzuara në kopje nga revistat shkencore.

2.3. Trajnime tjera:

1. Pjesëmarrje në aktivitetin me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara me temë "Nga sjellja sfiduese deri te përfshirja e plotë e nxënësve me aftësi të kufizuara", organizuar nga Fakulteti Pedagogjik i Universitetit të Tetovës në bashkëpunim me Qendrën për Shërbime Psikologjike dhe Zhvillim Neuro-gjinor "Piramida" – 2026, Shkup.
2. Pjesëmarrje në trajnimin "ABA-VR: Menaxhimi i sjelljes përmes realitetit virtual" dhe "Shtëpitë mbështetëse si klasa në banesat mbështetëse për personat me autizëm për ndërtimin e një jete të pavarur", kushtuar mbështetjes së personave me autizëm, menaxhimit të sjelljes dhe nxitjes së jetesës së pavarur - Prill, 2026, Tetovë
3. Pjesëmarrje në puntorinë "Nga klasa tradicionale te klasa virtuale- krijimi dhe përdorimi i syzevetë realitetit" – 13.11. 2025, Tetovë

4. Pjesëmarrje në puntorinë “ GeoGebra in classroom teaching”, 7 Nëntor, 2024, Universiteti i Tetovës.
5. Pjesëmarrje në puntorinë “ The role of play in childrens socio-emotional development: Pedagogical methods and practices”, 8 Nëntor, 2024, Universiteti i Tetovës.
6. Pjesëmarrje në puntorinë “Communication as a pedagogical category, self-confidence and art therapy techniques”, 15-17 November, 2023, Tetovë.
7. Pjesëmarrje në trajnimin për aftësitë e punësimit të organizuar dhe ofruar nga MYCareer, Programi Kombëtar për Intership dhe Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3. Veprimtaria profesionale-aplikative

Pjesëmarrje në aktivitete promovimi të fakultetit

- Pjesëmarrje në manifestimin Java e veçantë - “Nga ideja në sukses – Menaxhimi efektiv i projekteve” realizuar në Universitetin e Tetovës, më 27.10.2025 – 31.10.2025
- Pjesëmarrje në manifestimin Java e Veçantë Studimore, hulumtuese – shkencore, e organizuar nga Fakulteti Pedagogjik i Universitetit të Tetovës dhe Shoqata Arsimi nga Zvicra, e realizuar më 15.10.2024 - 18.10.2024
- Pjesëmarrje në manifestimin “Java e veçantë studimore - Diversiteti natyror e sociokulturor - Diversiteti si metodë hulumtimi e reflektimi”, e organizuar nga Fondacioni Arsimi Bildung Education nga Zvicra, i realizuar në Universitetin e Tetovës, më 30.09.2023 - 10.10.2023
- Ditët e hapura
- Pjesëmarrje aktive në organizimin e panairit të karrierës

4. Veprimtaria me interes më të gjërë

1. Anëtare e këshillit organizues ose programor të tubimit shkencor/profesional ndërkombëtar

Konferenca e pestë shkencore ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik, 6-8 nëntor 2024

Konferenca e gjashtë shkencore ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik, 12-13 nëntor 2025.

2. Anëtare e komisioneve të fakultetit

Anëtare e komisionit për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit Pedagogjik, 14 korrik 2025.

II. Përfundim

Në bazë të kreut I ky referat përmbyllet me recensimin e një kanditati. Sipas përshkrimit të lartëshënuar për kanditatin nga kreu i këtij referati dhe kushteve për zgjedhjen e bashkëpunëtorit sipas konkrusit, kanditatja Zana Kadrii Vladi, në dokumentacionin e dorëzuar me fletëaplikimin nr. 04-01/24 të datës 08.10.2026, i plotëson kriteret ligjore sipas nenit 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 178/2021), i posedon të gjitha dokumentetet e kërkuara:

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet me gjithsej 300 ECTS dhe notë mesatare të përshtatshme;
- Kontinuitet në studimet e ciklit parë dhe dytë nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër (CV);
- Punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve dhe certifikatë të shtetësisë.

III. Propozimi i komisionit recenzues

Në bazë të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit dhe kushteve të kërkuara për zgjedhjen e një asistenti në lëmin Edukim special dhe rehabilitim (5.03.00.10 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/2018 dhe Gazet Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 178/2021), Komisioni recenzues i propozon Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Pedagogjik:

- Kandidatja **Mr.sc. Zana Kadrii Vladi** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore një asistenti në lëmin Edukim special dhe rehabilitim (5.03.00.10 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Tetovë, më 17.11.2026

Komisioni recensues:

Prof. dr. Arita Agai, profesor inordinar në Universitetin e Tetovës në Tetovë, (kryetar)

_____

Prof. dr. Buniamin Memedi, profesor ordinar në Universitetin e Tetovës në Tetovë, (anëtar)

_____

Prof. dr. Teuta Ramadani Rasimi, profesor inordinar në Universitetin e Tetovës në Tetovë, (anëtar)

_____

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORËSHKENCORË, SHKENCORË MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidatja: ZANA KADRII VLADI

Institucioni: Fakulteti Pedagogjik, Universiteti i Tetovës

Fusha shkencore: Edukim special dhe rehabilitim (5.03.00.10, nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR - ASISTENT

Nr. rendor	**KUSHTET E PËRGJITHSHME**	**Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo**
1	Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi	**Po**
2	Titulli i fituar - magjistër i Edukimit special dhe rehabilitimit Emri i fushës shkencore – Edukim special dhe rehabilitim	**Po**
3	Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe të dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë – 8.29 Suksesi mesatar në ciklin e dytë – 8.43	**Po**
4	Ka njohuri nga së paku një gjuhë e huaj 1. Gjuhë e huaj - Angleze 2. Emri i dokumentit - Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit – Vision Academy - Tetovë 4. Data e dhënies së dokumentit – 04.09.20206	